mbarësi. Gruaja po të shohë vehten haize: është leqe. Po të bejë gusël prej hajzit: bën tobe. Në ëndër e mara borç: hidhrim. E lara borxhin: gëzim. E mara gjak: shëndet. E çelura portën: rahmet d. m. th. të zgidhen punrat e lidhura. Kush shtije më nishan: me mashkull gëzohet. Po të mos godasë dot, më nishan dëshira vonohet. Gruaja po të shtjerë më nishan: martohet. Lufta shënon shtrejtësirë. E therura: zullum. Po e therura dele pëllump dhe e rjepura: del martesë. E vulosura letrën shënon nëpunësi. Kush sheh pasqyrë të kulluar del i gëzuar. Pasqyr' e lëvrirë s'del mirë. Pasqyr' e florisht shënon dinë edhe pasuni. Në pasqyrë po të shohish fytyrën ndryshe, s'ësht mirë. I burgosuri në pasqyrën po të vështrojë: do të shpëtëjë. Kush sheh vehten në pasqyrë të mirë: përgëzohet me ovlad të hajrit.

(Vell-llahu ëalemi bissaváb).

Gjer këtu treguamë së cilat ëndra dalin hajir. (Por më në fund, themi ZOTI e di më mirë).

Nga Tabir name e madhe e ëndrave ca fjalë :

Dijën e ëndravet e kan pranuar gjith kombet. Për veç libravet. Turqisht. Arebisht q' i japin një rëndësi, po edhe në një libër ëndër-rëfenjse frëngjishte thuhen këto fjalë:

Ëndra ësht hak, e cila nga an' e hakikatit, ZOTI me të math të vet me anë e ëndravet na

njofton plot fuqinë edhe madhërinë e tij masandaj na shënon edhe rugat e drejta që i lyp njerëzimi. Të mënçmit që gjykojnë prej kësaj dije marrin pjesë. Ëndra ësht pasqyr' e njeriut, ata që janë nga syt e zemrës të squar, prej ksaj dije marin shumë kuptime.

Ëndra në çështje feje më disa pika ndryshon, për shëmbëll: Myslimani po të shohë verë (alkoli) për të shënon haram mall edhe ligësi. Muslimani në ëndër po të shohë mjaltë: ndjen shije besë. Po për të tjerët kjo: del shijë bote.

Si pas hënës ato dit që dalin ëndrat hajir thuhen këto: 1, 2, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 15, 17, 18, 20, 21, 22, 25, 26, 27, 28, 30, në të tjerat dit ëndra del vërejtje; pra jep dorëheqje nga keqpunimi edhe përmblith mirëvetinë.

Në ëndër kush sheh një njeri, le të bazohet në kuptim i emrit të tij. Për shembell: e para emrin: Emin! që ka kuptimin: shpëtim! shënon se pam si del i shpëtuar. Kuptohet se libri ëmrave ka lidhje me dijën ëndrave e prandaj po e bashkojmë edhe këtë më pas që të kuptojë si kush se ç' kuptim ka ëndra si pas emravet.

Kuptim i emravet Mysliman

Disa vëllezër Shqiptarë me qënë se na kërkuan kuptimin e emravet Mysliman, zgjothmë ato emrat më të mira me kuptimet më të plota që ti kemi gjithmonë si pasqyrë për Ditlindjen e fosh-